

VENDIM
Nr.1030, datë 8.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË RUBIK, TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Rubik të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Rubik të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.1465, datë 5.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Rubik, të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Rubik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Rubik

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 (Pa ndërtesën private)	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-36	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
37-44	Prona që përdoren për realizimin e programeve të shëndetit publik.	Në pronësi
45-47	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
48	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive në fushën e shërbimeve sociale.	Në pronësi
53-55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
56,189-199,201-203	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
204-212	Varrezat publike	Në pronësi
213-219,229-233,237-244,246-247,251-255,257,259-278,280-445,447-448,450-491,497-530,532-543,545-548,1272-1322	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

492-496,531,1325	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
1131-1132,1136-1137,1141-1143,1147-1148,1151, 1155,1159-1160,1164-1166, 1170-1172,1175,1178-1180,1184,1185	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
1133-1135,1138-1140,1144-1146,1149-1150,1152-1154, 1156-1158,1161-1163,1167-1169,1173-1174,1176,1177, 1181-1183,1186,1187, 1255-1271	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1229-1254,1323,1324	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi